



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

VENDIM Nr 127 Datë 20.12.2019

Për mënyrën e organizimit dhe të administrimit të kanaleve ujitëse dhe rezervuareve si dhe miratimin e tarifave. Referuar ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 54 pika f, (detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak), neni 64, pika c (Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë), VKM nr. 1108 datë 30.12.2015, Ligji 24/2017 miratuar date 09.04.2017, neni 15, pika 1,2,3,4, neni 16 pika a,b,c,ç,d, neni 17 (Tarifat vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës), neni 35, pika a dhe b, neni 36, pika 2.

Këshilli Bashkiak Dibër I mbledhur me datë 20.12.2019 me 17 vota pro:

VENDOSI :

1. Njësitë Administrative janë përgjegjëse për administrimin e kanaleve ujitëse dhe të rezervuareve, Drejtorja e Buqësisë kontrollon anën teknike të sistemeve ujitëse Drejtorja e financës kontrollon për mbledhjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse kontrollon për formalizimin e punonjësve që meren me ujitje.
2. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes të jetë 100 lekë dhe do të paguhet një herë në vit, brenda datës 31 janar të vitit në vazhdim.
3. Tarifa e shërbimit të jetë 100 lekë /ora, 30 litra /s.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Sekretare Këshilli

Inva Trupja

Kryetar Këshilli

Sokol Sava

Në mungesë dhe me porosi

Nën Kryetar Këshilli

Xhelal Ndreka

